



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Podujevës
Municipality of Podujeva
Opština Podujevo

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Ministartstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja

Prishtinë, 03.06.2026

Duke u bazuar në nenet 3, 6, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.7, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive (20.02.2026), nenet 5 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28, 04 qershor 2008), si dhe në Ligjin Nr.10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.4 / 2 mars 2026), lidhet kjo:

**MARRËVESHJE E DYTË
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I KANALIT TË UJITJES NË
KOMUNËN E PODUJEVËS – LUPÇ I POSHTËM”**

E lidhur ndërmjet:

1. **Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural** (në tekstin e mëtejme Ministria), e përfaqësuar nga Ministri;

dhe

2. **Komunës së Podujevës** (në tekstin e mëtejme Komuna), e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës.

Palët u pajtuan si më poshtë:

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ndryshimi dhe plotësimi i dytë i Marrëveshjes së Mirëkuptimit për financimin e Projektit ‘Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Komunën e Podujevës – Lupç i Poshtëm’, me qëllim të zgjatjes së afatit për realizimin e projektit.

Neni 2
Afati

Afati për realizimin e projektit zgjatet deri më datën 15 korrik 2026.

Neni 3
Dispozitat e pandryshuara

Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Financimin e Projektit 'Ndërtimi i Kanalit të Ujitjes në Komunën e Podujevës – Lupç i Poshtëm', si dhe të Marrëveshjes së parë për ndryshimin dhe plotësimin e saj, mbeten në fuqi dhe të pandryshuara, përveç ndryshimeve të përcaktuara me këtë marrëveshje.

Neni 4
Dokumentet përbërëse

Pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje janë kërkesa për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratës me nr. të prokurimit 615-25-1817-5-2-1, e miratuar nga Kryetari i Komunës së Podujevës më 29.05.2026, si dhe kërkesa e datës 02.06.2026 e dërguar nga Menaxheri i Kontratës.

Neni 5
Zgjidhja e kontesteve

Kontestet eventuale lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet palëve. Në rast se nuk arrihet marrëveshje, kontestet do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Neni 6
Kopjet e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Armend MUJA
Ministër në detyrë i MBPZhR-së



Shpejtim Bulliqi
Kryetar i Komunës së Podujevës

